

HISTORIK I SHKURT I SHKOLLËS “IBRAHIM KRASNIQI” SMALLUSHË

Në vitet 1947/48 filloi punën shkolla fillore e fshatit në gjuhën shqipe ku në klasë të parë kishte nxënës të moshave të ndryshme ndërsa klasa e dytë, tretë dhe katër ishin të kombinuara me nxënësit që mësonin në Sllovi. Kush ishte mësuesi i parë në këtë shkollë nuk e dimë (nuk ka shënime). Në vitin 1951 u rrit numri i nxënësve dhe mësimi zhvillohej nga klasa e 1-4 mirëpo në klasë të kombinuara 1-3 dhe 2-4 për shkak të mungesës së kuadrit arsimor. Mësimi mbahej në një ndërtesë të vjetër ku më parë ishte e dedikuar për rritjen e gjedheve të imta ku më vonë u adaptua në shkollë.

Nga viti 1947 deri në vitin 1960 shkolla jonë ishte shkollë amë kur Ministria e arsimit bëri reduktimin e shkollave dhe shkollën tonë e bëri paralele të ndarë të shkollës fillore “ Vëllazërim Bashkim” në Sllovi, ku më vonë shkollës iu ndërru emri në “Hasan Z. Kamberi”, pra shkolla e Smallushës deri më 12.06.1997 ishte paralele e ndarë e kësaj shkolle.

Me insistimin e mësuesve të fshatit dhe kërkesave të bëra nga fshati Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë e përkrahu iniciativën e tyre dhe nxjerrë vendimin Nr. 03-Nr.85-08 për Pavarësimin e paraleles së ndarë fizike në shkollë amë. Shkolla e pavarësuar emrohet me emrin e dëshmorit të fshatit “ Ibrahim Krasniqi”. Nga 12 qershori i vitit 1997 shkolla jonë me krenari e mban emrin e dëshmorit. Drejtor i parë u emërua Nazmi Krasniqi pas ti Hajrush Thaçi dhe në 12 vitet e fundit Servete Thaçi dhe vazhdon në udhëheqje të shkollës.

Sot, shkolla jonë ka kushte optimale për zhvillimin e punës edukativo-arsimore, duke ju falenderuar kryetarit të komunës z.Imri Ahmeti që bëri renovim të shkollës brenda e jasht, që pak a shumë të kemi një ambient më të favorshëm për punë. Njëherit këtë vit jemi paisë edhe me disa mjete konkretizimi per lëndët e shkencave nga DKA – Komuna.

Po ashtu falë Granteve shkollore të Bankës botërore, MASHT-it, DKA-së dhe bashkëpunimit me kordinatoren Vlora Zenuni si dhe angazhimit tonë, shkolla është paisur me teknologji informative si: Llaptop, projektorë, perde për projektorë, mjete konkretizimi etj. Por, edhe investimi në cilësi siç janë: trajnimet dhe vizitat e bëra, që ndikuan në mësimdhënie e nxënie cilësore.

Sot, secili mësimdhënës mund të zhvilloj një orë mësimi që të jetë atraktive për nxënësit duke e përdor teknologjinë dhe microbit-in për dhënie e njohurive të reja dhe realizimin e projekteve. Mbetet punë dhe përkushtim i mësimdhënësve të përdorin teknologjinë dhe të përhapin dije e inovacion te nxënësit.